



ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS • KOSOVO DENTAL CHAMBER • STOMATOLOSKA KOMORA KOSOVA

**KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK)**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafët 1.12, 1.13 dhe 1.14 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 20, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12, 1.13 dhe 1.14 dhe Nenit 40, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Statutit të OSK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 30.10.2018, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË DHE SISTEMIN E TAKSAVE ADMINISTRATIVE

- I. CAKTOHET kuota e anëtarësisë për anëtarësim në Odën e Stomatologëve të Kosovës, e cila paguhet në bazë vjetore, si në vijim:
  - në shumë vjetore prej 48.50 € që do të përlllogaritet në përqindje ekuivalente për nevoja të ekzekutimit në sistemin publik të pagave, mbi shumën e pagës bazë neto për të punësuarit në institucione publike shëndetësore;
  - në shumë vjetore prej 48.50 € për stomatologët që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin privat; dhe
  - në shumë vjetore prej 100.00 € për mjekët e huaj që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Kosovës.
  
- II. PËRCAKTOHET sistemi i taksave administrative për procedurat administrative që iniciohen pranë organeve të Odës së Stomatologëve të Kosovës, si në vijim:
  - Taksa administrative për dhënie të licencës së punës në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
  - Taksa administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike ("Certificate of good standing") në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro) për përdorim brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe në shumë prej 30.00 (tridhjetë) € (euro) për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
  - Taksë administrative në shumë paushalle për çfarëdo vërtetimi apo lëshim të dokumentit me karakter publik në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro).
  - Taksë administrative për lëshimin e vërtetimit dhe lejimit e eksperimenteve nga Komisionit për Etik Stomatologjike për studime Shkencore kërkimore në lartësi prej 200,00 € (euro);
  - Taksë administrative në rast të aplikimit për organizim të eventeve të ndryshme Profesionale në lartësi prej 200.00 € (euro);

- III. Taska administrative për iniciimin e procedurës së licencimit dhe rilicencimit nuk kthehet në rast të refuzimit të licencimit apo rilicencimit. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për iniciim të procedurës do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshim të licencës së punës.
- IV. Taksat administrative deponohen në xhirrollogarinë e OSK-së dhe me para të gatshme në pajtim me dispozitat e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OSK-së.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 30 tetor 2018



Kryetari i OSK-së  
Dr. Kujtim Shala